

Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes

Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes në bashkëpunim edhe me stafin akademik që në fillim të vitit akademik, planifikojnë veprimtaritë kërkimore-shkencore që do të kryejnë përgjatë vitit akademik. Realizimi i këtyre planifikimeve, përmbushja me sukses e tyre si edhe veprimtari të tjera të cilat lidhen me këtë fushë, ndiqen me seriozitet nga departamenti për një realizim sa më të arrirë të tyre.

Për vitin akademik 2018-2019 janë planifikuar këto aktivitete shkencore si më poshtë:

❖ Aktivitetet shkencore në rang Departamenti

1. Departamenti i Edukimit në bashkëpunim me Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme, Departamentin e Shkencave Politiko-Administrative dhe Departamentin e Shkencave Juridike në 5 nëntor ka planifikuar të organizoj një takim në Bibliotekën Kombëtare me studentët e viteve të para. Ky takim do të ketë në fokus kërkimin shkencor.
2. Në muajin Dhjetor Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në "Albanian University" në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Kolegjin Universitar Qiriazhi do të organizojnë Konferencën e 5-të Shkencore Ndërkombëtare "*Problemet dhe Sfidat e Transformimit të Shoqërisë Shqiptare Drejt Standarteve të Bashkimit European*", në të cilën kanë shfaqur interes në pjesëmarrje pedagogë efektiv dhe me kontratë të Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes.

Synimet e kësaj Konference Multidisiplinore Shkencore Ndërkombëtare me temë "*Problemet dhe Sfidat e Transformimit të Shoqërisë Shqiptare Drejt Standarteve të Bashkimit European*" është të stimulojë debatin ndërmjet akademikëve, ekspertëve, përfaqësuesve të organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare, grupeve të interesit, etj..., për të bërë të mundur prezantimin e rezultateve më të rëndësishme të kërkimeve të tyre për çështje, probleme dhe procese të një interesi madhor. Në këtë konferencë do të marrin pjesë pedagogët e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes, të cilët me kumtesat e tyre do të sjellin çështje të ndryshme të arsimit në Shqipëri dhe jashtë saj.

3. Në muajin Dhjetor Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes në kuadrin e vitit të Skënderbeut, do të organizoj një leksion të hapur me akademikun dhe historianin Prof.Dr. Pëllumb Xhufi.
4. Zhvillimi i një konference studentore në rang Fakulteti, është bërë traditë për Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes. Në periudhën Prill-Maj Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes në bashkëpunim me departamentet e tjerë të Fakultetit të Shkencave Shoqërore do të organizoj një konferencë studentore, në të cilën do të përfshihen studentët e programeve të studimit Master profesional në Pedagogji me profil "Didaktikë" dhe "Menaxhim arsimit", Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" dhe "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", "Anglisht". Kjo konferencë ka si qëllim aktivizimin e studentëve në aktivitetet ekstrakurrikulare dhe impenjimin e tyre drejt kërkimit shkencor.
5. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes do të organizoj herë pas here në perioda të ndryshme leksione të hapura me personalitete në fushat përkatëse të arsimit.

❖ Punime shkencore në nivel individual

Puna shkencore individuale është parë me përparësi nga ana e stafit akademik të Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes. Kjo për arsye të përmbushjes së kriterëve për mbylljen me sukses të ciklit të tretë të studimeve. Stafi akademik për vitin akademik 2018-2019 ka planifikuar pjesëmarrjen në një sërë konferencash kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara brenda dhe jashtë vendit, si edhe ka programuar botime në revista shkencore artikuj të ndryshëm sipas fushës së studimit të tyre. Kjo gjë do të reflektohet në dokumentet që do të depozitohen çdo fund viti akademik në departament, "formulari mbi aktivitet shkencore të realizuar përgjatë vitit akademik".

❖ Aplikimi në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare

Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes në muajin Mars 2018 ka aplikuar në një projekt ndërkombëtar dhe është në pritje të përgjigjes. Drejtuesi i Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes Dr. Ndriçim Mehmeti ka aplikuar në dy projekte: *“The Children's Rights, Multiculturalism and Their Implementation for the Education of Roma Children”*, *“Technical Assistance to Coordinate and Implement National Reforms in the Field of Employment and Skills (NESS)»* - EuropeAid/138484/IH/SER/AL, për pozicionin: Senior Local Non-Key Expert for Equipment Assessment in MFC, Golem Berat and Vlore për të cilat është në pritje të përgjigjes. Gjithashtu edhe për vitin akademik 2018-2019 do të ketë aplikime nga stafi akademik për pjesëmarrje në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.